



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 201501351/7

Tiranë ____/____/2016

Lënda : *Rekomandohet marrja e masave sa më pare e mundshme për nxjerrjen e udhëzimit për caktimin e tarifës së shërbimit nga ana e organeve të ngarkuara sipas pikës 10 të VKM nr.608, datë 05.09.2012, të ndryshuar.*

Drejtuar : **SHTZ.Edi Rama**
Kryeministër i Republikës së Shqipërisë

TIRANE

SHTZ.Kryeministër!

Institucioni i Avokatit të Popullit ka iniciuar kryesisht, shqyrtimin e çështjes lidhur me detyrimin e Ministrit të Financave dhe Ministrit të Brendshëm për nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët, sikundër përcaktuar në pikën 10 të VKM nr.608, datë 05.09.2012, *"Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërthuara deri më 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre"*, të ndryshuar, në të cilën përcaktohet se:

"Përfituesi i pasurisë së paluajtshme, në kohën e marrjes së certifikatës së pronësisë, paguan në numrin e llogarisë së caktuar nga institucioni i autorizuar tarifën e shërbimit. Masa e tarifës së shërbimit caktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Brendshëm".

Gjatë shqyrtimit të rasteve të pranuar, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka konstatuar se, shkak për mospërfundimin e procedurave të kryera në funksion të zbatimit të VKM Nr.608, datë 05.09.2012, të ndryshuar, është mungesa e udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve të Brendshme, për përcaktimin e tarifave që duhet të paguajnë përfituesit e pasurisë së paluajtshme, konform pikës 10 të VKM nr.608, datë 05.09.2012, të ndryshuar.

Ndodhur në situatën e mosnxjerrjes së udhëzimit të përbashkët, sikurse përcaktuar në pikën 10, të VKM nr.608, datë 05.09.2012, të ndryshuar, është kërkuar Ministrisë së Financave si dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, informacion rreth veprimeve të

mundshme të kryera për përmbushjen e detyrimit të përcaktuar në pikën 10 të VKM nr.608, datë 05.09.2012.

Ministria e Financave, në shkresën nr.13578/1 prot, datë 08.10.2015, drejtuar Avokatit të Popullit, shprehet se;

“... kemi paraqitur në Ministrinë e Drejtësisë kërkesën për ndryshimin e pikës 10 të VKM nr.608/2012, për të lënë në kompetencë të njësive vendore vendosjen e nivelit të tarifës së regjistrimit. Ky propozim nuk është pranuar duke u sugjeruar, që kjo tarifë të jetë fikse dhe të mos variojë sipas njësive vendore. Aktualisht jemi përpara një situatë të pazgjidhur edhe pas një përpjekje 2-vjeçare të bërë nga Ministria e Financave, për adresimin e kësaj çështjeje...”

Ministria e Punëve të Brendshme, në Shkresën nr.7302/1 prot, datë 01.10.2015, drejtuar Avokatit të Popullit, shprehet se;

“... është ndjekur një korespondencë ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Financave, objekt i së cilës është përcaktimi i moskompetencës së Ministrisë së Punëve të Brendshme, për të përcaktuar tarifat e shërbimit, si detyrim i pikës 10 të VKM-së së mësipërme. Gjithashtu, nga ana jonë është përcaktuar se Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka një structure të veçantë për trajtimin e çështjeve financiare që lidhen me njësitë e qeverisjes vendore. Në vijim, Ministria e Punëve të Brendshme ka shprehur gatishmërinë për bashkëfirmosje të prokejtudhëzimit pas përcaktimit të tarifës nga ana e Ministrisë së Financave”

Gjithashtu, referuar konfirmimit të dhënë prej Ministria e Financave, i jemi drejtuar Ministrisë së Drejtësisë për dhënie informacioni rreth kësaj çështjeje.

Ministria e Drejtësisë, në përgjigje të informacionit të kërkuar, me shkresën nr.2979/1 prot, datë 05.05.2016, drejtuar Avokatit të Popullit, shprehet midis të tjerave se;

“Si Ministria e Financave, ashtu dhe Ministria e Punëve të Brendshme nuk mund të ngrenë pretendimin se nuk kanë kapacitete, kompetencë dhe ekspertizën për përcaktimin e kësaj tarife.

Sa më sipër, ashtu siç jemi shprehur dhe më parë, detyrimi për miratimin e këtij projektudhëzimi dikton nevojën e bashkëpunimit proaktiv të dy institucioneve të ngarkuara nga VKM nr.608/2012 për nxjerrjen e udhëzimit. Në funksion të plotësimit të boshllëkut ligjor lidhur me përcaktimin e tarifës së shërbimit dhe të ecurisë normale të punës, lind nevoja e hartimit dhe bashkëfirmosjes së udhëzimit, sipas përcaktimeve përkatëse të VKM nr.608/2012”

Mospërmbushja e detyrimit për nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët prej ministrive të lartpërmendura, nuk lejon zhvillimin e procedurave në përputhje me përcaktimet e VKM nr.608/2012, të ndryshuar, duke cënuar në këtë mënyrë parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës apo nenin 6/1 të Konventës Evropiane e të Drejtave të njerit, ratifikuar me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, prej Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Ndodhur në këto kushte, si më sipër prezantuar, Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin

parashikohet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenit 21/b, se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”.

REKOMANDON

Marrja e masave sa më pare e mundshme për nxjerrjen e udhëzimit për caktimin e tarifës së shërbimit, sipas pikës 10 të VKM nr.608, datë 05.09.2012, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.
Me besim në bashkëpunimin tuaj.

Bashkëlidhur ju dërgojmë;

Kopje të Shkresës Nr. 2979/1 prot, datë 05.05.2016, të Ministrisë së Drejtësisë drejtuar Avokatit të Popullit.

Kopje të Shkresës Nr. 13587/1 prot, datë 08.10.2016, të Ministrisë së Financave drejtuar Avokatit të Popullit.

Kopje të Shkresës Nr. 7302/1 prot, datë 01.10.2016, të Ministrisë së Punëve të Brendshme drejtua Avokatit të Popullit.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI